




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik

14 Nr. 872/23

Dt. 24.08.2023

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. “ BD Trade ”sh.p.k. & “ Infra Plus ‘sh.p.k. me seli në Skenderaj, kundër Njoftimit mbi Vendimin e A.K. të dt. 14.08.2023, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 63 paragrafi 63.1.2 të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik, më datën 24.08.2023 bie këtë:

V E N D I M

- 1. Apropohet** pjesërisht si e bazuar Kërkesa për rishqyrtim e datës 19.08.2023, e subjektit në procedurë: “ BD Trade ”sh.p.k. & “ Infra Plus ‘sh.p.k. me seli në Skenderaj, , për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit në aktivitetin e prokurimit : “ Rregullimi i shtratit të lumit Tërstena, Podrança dhe lumenjve në fsh. Studime dhe Smrekonicë “ me nr. të prokurimit : VU644 – 23 – 7150 – 511 dhe Nr. i brendshëm : VU644 – 23 – 070 – 511
- 2. Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së dhe nenin 63 paragrafi 63.1.2 të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik do të ndërmarr veprimet procedurale në pajtim me dispozitat e LPP-së që rregullojnë këtë çështje.**
- 3. Vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes.**

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik më dt. 14.08.2023 në Platformën elektronike E-prokurimi ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e A.K. për aktivitetin e prokurimit : “ Rregullimi i shtratit të lumit Tërstena, Podrança dhe lumenjve në fsh. Studime dhe Smrekonicë “ me nr. të prokurimit : VU644 – 23 – 7150 – 511 dhe Nr. i brendshëm : VU644 – 23 – 070 – 511

Në Kërkesën për rishqyrtim të vendimit të A.K., e parashtruar nga Op. Ek.- Ankuesi, e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjore, Ankuesi konsideron se me rastin e marrjes së vendimit të dt. 14.08.2023 janë shkelur dispozitat e : nenit 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe nenit 69 – aftësia teknike dhe / ose profesionale , sepse, sik urse pretendon Ankuesi, vlerësimi i tenderëve nuk është bërë në plotni dhe në pajtim me nenin 59 të LPP-së, rrjedhimisht sipas Ankuesit , O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i përmbushë kërkesat e saktësuara në FTD – Kërkesat nga neni 9.1 lidhur me 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe ose profesionale.

Pasi u shqyrtuan pretendimet e Op. Ek. të dhëna në Kërkesën për Rishqyrtim, duke marrë për bazë dhe vlerësimin dhe të gjeturat gjatë mbajtjes së seancës jo publike, A.K. konstaton se Kërkesa për Rishqyrtim e Op. Ek. është pjesërisht e bazuar, për arsye se :

Lidhur me pretendimin e Ankuesit sa i përket Listës së Kontratave të realizuara, me theks të veçantë sa i përket Kërkesës së A.K. që Lideri i Grupit të OE. të ketë përmbushur 60 % të vlerës prej 700,000.00€ të projekteve të përfunduara, A.K. në procedurën e rivlerësimit të tenderëve do të ketë kujdes që të zbatohen dispozitat e LPP-së në plotni , në veçanti të nenit 59 lidhur me ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve ashtu që të arrihet deri te një vendim sa më i qartë, i drejt dhe në pajtim të plotë me dispozitat e LPP-së.

Sa i përket pretendimeve lidhur me Stafin profesional, me theks të veçantë Kontratës mbi Vepër të lidhura me O.E. dhe Kontraktuesve të angazhuar, A.K. vlerëson se nuk është kërkuar ndonjë formë e veçantë e përmbajtjes së dokumentit – kontratës andaj vet O.E. vendosin se si do të duket dhe çfarë përmbajtje do të ketë një dokument, në rastin konkret një kontratë. Sikurse vlerëson A.K. është me rëndësi që dokumenti të jetë i qartë dhe me qëllime të qarta për palët dhe A.K. Klaozola e përdoruar te

kontrata mbi veprën se , citat : “ angazhimi i kontraktorit do të jetë maksimal dhe në periudhën prej nënshkrimit të kontratës e deri në përfundimin e saj “ mbarim i citatit, për A.K. ka qenë e mjaftueshme që një dokument i tillë të vlerësohet si pranueshëm, ndërsa sa i përket pretendimit lidhur me dokumentet e dorëzuara për Inxhinjerin e gjeodezisë, A.K. vlerëson se fakti se O.E. me inxhinjerin e gjeodezisë, z. Samedin Gërzheliu ka pasur bashkëpunim dhe angazhim në punë tregon se inxhinjeri në fjalë është staf i cili në vazhdimësi bashkëpunon me O.E. dhe kryen punë për O.E. ndërsa që thirrja në projekte tjera sipas A.K. vlerësohet si një gabim teknik i cili mundë të ndodhë, por që në rastin konkret është plotësuar me dokumente tjera valide si Diploma mbi përgatitjen profesionale si dhe performanca e punës e inxhinjerit e pasqyruar përmes të dhënave të specifikuara në CV-in e tij , e cila lënë për të dëshiruar sa i përket përvojës dhe performancës së tij. Megjithatë edhe ky pretendim ankimor do të vlerësohet dhe shqyrtohet në pajtim me dispozitat e nenit 59 të LPP-së në procedurën e ri-vlerësimit të tenderëve.

Ndërsa, sa i përket pretendimit lidhur me datën e lidhjes së kontratës me Inxhinjerin e Ambientit z. Ruzhdi Feka, A.K. vlerëson se lidhja e kontratës para apo pas inicimit të aktivitetit të prokurimit nuk e bënë kontratën jo valide, aq më tepër pasi që, sikurse vlerën A.K. , aktiviteti i prokurimit në fjalë është i përfshirë në planifikim përfundimtar të prokurimeve të A.K., i njëjti është i publikuar për informacion të të interesuarve dhe , bazuar në këtë çdo palë e interesuar mundë të vije deri te informacioni lidhur me ekzekutimin e projekteve të planifikuara nga A.K. për vitin kalendarik gjegjës, andaj pretendimi i Ankuesit lidhur me çështjen në fjalë është refuzuar si i pabazuar.

Pretendimi se Planin për menaxhimin e trafikut nuk paraqet dokument të rregullt sepse , sikurse theksohet në Kërkesën për Rishqyrtim, nuk ka detaje se si do të menaxhohet trafiku, nuk ka skema, vizatime apo ndonjë ilustrim si do të menaxhohet trafiku gjatë punimeve, sikurse vlerëson A.K. pretendimi ankimorë është i pabazuar për faktin se kërkesa të tilla sikurse u theksuan më lartë nuk janë specifikuar në Kërkesën nr. 5 të FTD-së prandaj një pretendim i tillë është refuzuar sepse A.K. nuk mundë të refuzoi një tender për ndonjë kërkesë e cila nuk është specifikuar në FTD, duke qenë se dokumeti i tillë është i nënshkruar nga Inxh. I komunikacionit, z. Florim Shala.

Gjithashtu edhe pretendimi lidhur me kontratat e stafit të punëtorëve teknik sikurse ka vlerësuar A.K. nuk është i bazuar për faktin se, me theks të veçantë Kontratat mbi Veprën janë dokumente që angazhojnë punëtorin për projektin i cili është i specifikuar dhe emërtuar dhe me klauzolën , citat : “ përdurja e ekzekutimit nga data e lidhjes së kontratës deri në përfundimin e saj “ mbarim citati, që për A.K. , sikurse është vlerësuar , është e mjaftueshme dhe paraqet dokument të rregullt dhe të pranueshëm. Zgjidhjet e ndërmarra nga A.K. të cilat konsiderohen se i përmbushin dhe kërkesat dhe / ose pretendimet e Ankuesit, të saktësuara në Kërkesën për Rishqyrtim, A.K. në procedurën e ri-vlerësimit të tenderëve do ti inkorporoi, vlerësoi dhe implementoi në pajtim të plotë me dispozitat e LPP-

Nga sa u tha më lartë, e në përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 63 paragrafi 63.1.2 të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtrori Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë
K.R.. nr. 070/2023, datë 24.08.2023

Aktvendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve
2. DKP
3. Arkivit (1 kopje)

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik


Alban Tahiraj